

1. ZHAN-PIER SIMEON (FRANCA)

ELEGIA PËR LIQENIN E OHRIT

Jordan Plevneshit

Si të gjithë ata që pa kursyer janë të përkushtuar
Ndaj këtij besimi kaq të fortë dhe të shkretë
Dhe të cilët e lënë veshin mbi trupin e zhdukur
në varrin e Shën Naumit
duke besuar se do të dëgjonin si rreh zemra e shenjtorit

Ata nuk dëgjojnë asgjë tjetër
përveç zemrës së ëndrrës së tyre -
kështu që një ditë dikush i ngjashëm me Më të Lartësuarin
e vendosi në tokën e Maqedonisë

dhe duhet të ketë qenë poet -
Liqeni i Ohrit si një vesh i dhënë botës
Për të dëgjuar jehonën e nëndheshme nga liqeni
si i rreh pulsi
Sepse çfarë do të ishte njeriu
Po të mos shtyhej si një barkë e shqetësuar
Duke kërkuar bregun e shkretë përmes ujërave mijëvjeçar
Dhe ç' do të ishte kalimi përmes një ditë të zakonshme
Nëse nuk nënkuptonte një pritje të pasigurt të
Netëve të largëta
Nga të cilat jehojnë amfora dhe eshtra
Ç' do të ishte njeriu
Ai i etur i përjetshëm pas horizonteve
Sikur ta dinte se gjurma e tij në liqen
Nuk do të lërë asgjë
Në hijet e së shkuarës që flejnë
përgjithmonë në ndërgjegjen e tij
përgjithmonë ky është amaneti i tij
ritualesh dhe ëndrrash
Dhe fundja ç' do të ishte
Vetë bota
Pa liqenet e veta të Ohrit
Pa manastiret e saj të fshehura shkëmbinjve
Pa shpresën e braktisur përjetësisht

Pa rrënojat e kaq shumë luftërave
Dhe pa poetët e saj që thurin legjenda
duke ecur teposht kujtesës
zbathur dhe me krahët hapur ndaj stuhisë
sepse janë të vetmit që e kuptojnë
se kënga e fshehtësive shekullore
do t'i mbrojë nga kërcënimet e përjetshme
nga ligjet e uraganit

2. KATRIN PIC (GJERMANIA)

ME NET NË ATELIE

që ta hapësh dritaren e ateliesë domosdoshëm do të duhej
të ishe aventurier ishin fjalët e njerëzve të fare sit
të tjerët jetojnë në kushte më të mira
do të duhej patjetër, patjetër edhe ti e kush i zgjodhi
ëndrrën dhe dyshtemenë e ateliesë
kush u përcaktua të bëhesh depresiv
ta hapë dritaren kush deshi
më së pari xhemperin ta hekurosësh
t'ia hekurosësh dikujt xhemperin
ta hekurosësh edhe një ndonëse në dritaren e hapur
të gjithë u ngrimë si peshqit në akull me të vërtetë të gjithë
së bashku biem në nënkresa e shtretër
dikush përkundet, përkundet vetë, por jo që të !ejë
natën u ngri gjakosja në hundë
në gishta na ngrinte gjaku nga prekja e paevitueshme
kabllo çeliku të bëra për ngjitje lart u ngrinë në ajër
në imazhe u qëndronin kabllo rrëqethëse skajet hajde, hajde
i mungonin binarët ndihmesat shikimet
therjet në pëlhurë si në një organ
dikush këtë dhomë e quajti burg
por për ne dritaret ishin të hapura
për ne ende kishte shpresë

marrëveshjet tjera sillnin bashkim
vizitat e profesorit normalitet
atëherë dritaret ishin të hapura avulloheshin gjërat
pikturat që do të mbeten të tëra
që do të varen, varen
që do të mjekohen, mjekohen
cilat sëmundje do t'i marrim paraprakisht
cilat do të shërohen, shërohen
dritaret janë të hapura, peshqit të ngrirë

3. KATICA QULLAVKOVA (MAQEODONIA E VEIRUT)

TRE RRËFIME

"Unë, Eliezeri i Tirit, Feniki".
motra e grykësit Pigmalion
e njohur si Didona, mbretëresha e Kartagjenës
thonë - e aftë në bisedime
ngrita një qytet në det, në tokë të huaj
në territorin që e pushtova me lëkurën e një demi.

Për një natë shërbëtorët prenë lëkurën
në një shirit aq të hollë dhe të gjatë sa bëra një gjysmërreth
mjaft i madh për të ngritur Kartagjenën.

Sipas marrëveshjes me mbretin e Libisë”.

“Ne, murgjit nga Maqedonia
ngritëm manastire në vende që nuk i kishim.
Si në sagat e vjetra, kërkuam nga valiu
një vend aq të madh sa mund ta mbërthej
lëkura e thjeshtë e buallit. I yni, i këtuhi.
Do ta kishim prerë brenda një nate në shirita aq të hollë
sa të mbulonim disa kilometra në diametër.
Kështu e ruajtëm tokën e popullit tonë dhe nderin tonë.
Fenë gjithsesi askush nuk mund të na merrte.

Sipas marrëveshjes me valiun.”

“Nëse jo ne, do të gjendet dikush tjetër”.
për të nënshkruar paktin me djallin"
thonë sot guvernatorët e shteteve
të planifikuar për shpërbërje.
Të preokupuar nga ndjenja e fuqisë kalimtare, false dhe pis
grykës si Pigmalion
e përbirojnë gjithë pasurinë e popullit
përmes vrimës së gjilpërës, në çast, pa iu dridhur syri
duke dëgjuar jehonën e monedhave të arit.
Ata, pa ideale dhe të padenjë

të trullosur nga vorbulla e ruletit
dhe të paaftë në poker, luajnë për të humbur.

Sipas marrëveshjes me djallin.”

4. PETER ZAVADA (HUNGARIA)

$C_{17}H_{21}NO_4$

1.

Në prill të vitit 1505 derisa egërsia e pronarëve spanjollë të tokave depërtonte thellë në tokën e plantacioneve me koka të inkëve, gëmusha koka, me shushurimën e vet karakteristike të kadifenjtë, defiloi nëpër Evropë.

Këtë po e tregon derisa gishtat e tu shtrëngohen rreth grykës së ftohtë të shishes, ndërsa shishja rreth shijes së zezë të bërë vija-vija: unazë me dy rrathë.

Pakt paqësor, the, midis tregtisë dhe traditës.
E çfarë privilegjesh ofron!
Emri mbeti, po përbërca aktive mbetet në harresë,
e hedhur në harresë qysh në fillim të shekullit.

Tash po spekulohet vetëm me proporcionin e llojeve të sheqerit në versionet evropiane lindore;
si i përshtaten klimës lokale politike,
kushteve momentale meteorologjike.

2.

Amerigo Vespuçit i duhej kohë ta vërejë
qëndrueshmërinë e parëndomtë të minatorëve peruanë të argjendit.

Deri atëherë feudalët spanjollë që moti i paguanin tatimet
me fletë ngjyrë të gjelbër të mbyllët.

Sipas teje ajo që është shqetësim i brendshëm në tokën amë
nëpër koloni është rehati prridhëse.

Kurse unë jam Abraham Kauli, sekretar
i besueshëm, diskret i dyshe mbretërore të Anglisë
dhe pikërisht po e hartoj në formë të vjershës
shënimin e parë për gëmushën.

“Oh, Afrika perëndimore, Meksikoja, Kolumbia!
ku në xhungël është e prekshme larushia e llojeve,
e drurët me blerim të përhershëm janë të gjatë gjashtë – dhjetë metra!
Na bëni gjethe zgjatoshe, ovale,
Lule të verdha me lara të kuqe!
Sillni fryte pesëpjesëshe!
Oh, Rendi i Malvaceaeve, oh tanksoni pantropik, oh!

3.

Po e gërryen etiketën me rezignim, shkrimin
e shtrembëruar të Spenserit, shiritin e bardhë të diskut të kuq.
Asnjëherë nuk do ta marrim vesh cilat kanë qenë përbërëcat e fshehta
në thesaret e sigurt të bankës “San Trast”. A përmbanin
lot të dardhës me gjemba nga Korzika, djersën e salamandrit të verdhë.

Si duket bashkimi i një recete të grisur për gjysmë
midis dy drejtorëve të kompanisë të prirë për fyerje,
a nuk është ky simboli më i bukur i miqësisë së parimeve?

Ndërkohë ndihet era e zezë me erëza e arrave kola,
Si shkon zvarrë e përbirohet ndër shekuj.

4.

Në lëng reflektohet fytyra e Frojdit të përgjumur
si bredh natën nëpër të gjitha njësitë
e Allgemeines Krankenhaus-it, ndërkohë që morfinizmi
migrena dhe impotenca e humbin, së paku përkohësisht,
betejën kundër benzoilektonin metil esterit.

Në vijim, një grup emigrantësh nga viti 56, zbresin me shqetësim
nga anija ë Kamp Kilmer. Rrinë në këmbë në radhë në liman
para automatit të vetëm për “koka kole”.

Dhe tash, para syve tanë, shirita të përlyer të autostradës
në formë të yllit, në natën e tretur në Atlantë.

Sorra midis vijave të errëta të fushës,

Diku në afërsi të fabrikës për mbushje në Dunaharasti.

5. IVAN XHEPAROSKI (MAQEDONIA E VERIUT)

FSHATRAT E MALIT TË SHENJTË

*"Manastiret e Malit të Shenjtë
janë fshatrat e Shën Marisë"*

Domentian Hillendarit

Sa janë më të mëdhenj
qytetet
prej nga vijmë
në Malin e Shenjtë
aq më e madhe është
vetmia jonë.

Dhe këtu na mirëpresin
manastiret -
ata të qetët
fshatra të Shën Marisë,
ato livadhe me lule
me pemë të lulëzuara.
Ato ale erëmira
murgjish
të cilët ngadalë
me paqen e lutjes,

këndojnë si
zogj parajse.

Sa janë më të mëdhenj
qytetet
prej nga vijmë
në Malin e Shenjtë
aq më e madhe është lumturia
nga takimi me *qytetarët qiellorë*.

6. RUI KOIAS (PORTUGALIA)

SHTEGU

Këto duar po i dhelin çastet e udhëtimit,
shtyllat dhe mozaikët, arkitekturën
e pjergullave, të hirit, dhe hapërojnë në heshtje. Pastaj
asgjë nuk do të ngjajë me qendrën, kurrë nuk do të kthehemi
ta shohim luhatjen e udhëtarëve dhe të zezën e errët
të natës që rrjedh – a do të ketë kuptim
të tretim duke lënë gjurmë? Ta lëmë jetën
që ka ekzistuar, historinë tonë
që po shndërrohet në psherëtimë të shqetësuar? Vetëm disa fragmente
shohim kur më nuk ekziston asgjë – atje ishin dynat e zhveshura e të stërmëdha
dhe fushat që kanë lënë hije të errëta, dhe
njerëzit që kanë jetuar, por, duke shikuar nga larg
konkluzionet sikur na e turbulluan sigurinë.
Asgjë nuk është e sigurt, asgjë nuk bëhet e kuptueshme
që ta përfshijë në vete në të cilën ç'është e vërteta secili prej nesh
e ndjek rrugën që përnjëherë shfaqet dhe në fund tretet,
e thelbin e së cilës nuk e dimë a e prekim. Nuk e dimë
a është e jona e jonë, e as a do të arrijë te të tjerët,
ose, ndoshta, është një qelq i prerë të cilin gjithkush e sheh si ndahet
në horizont nga momentet e lidhjes me jetën
dhe me të e ka jetuar me të tjerët;
ose nëse çdo pikë është pafundësi vetvetiu,
atëherë është pluhuri që mbetet pranë nesh, pasqyrim i

formës së vet, tokë abstrakte
ku qëndron qielli, deti, koha e ligë, atje ku
ne e pikasim fundin që i nënshtrohet materies,
e që në të vërtetë është fundi.

7. DIMITAR BASHEVSKI (MAQEDONIA E VERIUT)

LIQENI MIDIS MALEVE

Liqen me një ishull, plagë e shenjtë,
stolisur me një gjerdan anemonësh.

Prej tij shkëlqen syri i dragoit,
zoti i thellësive.

Poshtë, në fund, unaza e
vajzës, besnikes së poetit.

Ai mpreh lapsin. E rrotullon
globin. Ai bën qiell
me diellin flakërues që rreh drejt
në syrin me mllef të dragoit.

Në vargun e fundit flakëron
liqeni. Ai gjen një re aq
të lehtë sa as hije bën, as shi resh.

Dhe, liqeni thahet dhe poeti përmes
shkallëve me vargje zbret në
fund dhe me një zanore
merr unazën e arit, sipas
Poetikës së gjinisë.

8. PATRIK KOTER (IRLANDA)

KËNGË PËR TOP LISTËN

Para luftës fëmija që hapëronte vetëm me duar
mundte të shkelë edhe në shputa po të donte, por i pëlqente
kur aty-këtu qepallat e preknin tokën në të cilën
argëtohej duke i shikuar aventurat e thneglave,

duke zënë vemëza me trupa të gjatë dhe me qime, që pastaj t'i kthejë
prapa në strofullin e tyre në gostinë e madhe. Sa lagej toka,
paraqitej një mizëri kërmijsh të cilët me bririthit e tyre ia xigëlonin
hundën. Mundte të bëjë biseda të fshehta me hijen e vet,

të pëshpëritin midis vetes gjëra të padëgjueshme për askënd
përveç se për krimbat dhe lugaveshët të cilët shpejt e shpejt iknin nën gjethe.
Në shtëpi, ndërkaq, hante nga pjata e qenve në dysHEME sepse ashtu
e ëma e kishte lazdruar. Kur binte natën të flejë, rrinte varur kah e prapa

si kurth tërkuzë e zbrazur varur në lëpozë.

E ëma u thoshte njerëzve se shkollohet në shtëpi, pohonte se
është tepër inteligjent sepse në këtë mënyrë më shumë i qarkullonte gjaku në tru.
Gjithçka mbaroi ditën kur s'kishte kujt t'i qante, kur

mbetën vetëm pika të përgjakura nga mbetjet e trotuarit ku qëndronte
i ati kur e copëtoi shrapneli i shpërthyer. Para luftës,
sa ia niste vajit, i ati kërrusej deri poshtë,

prekeshin fytyrë më fytyrë dhe e pyeste “Ku e mësove këtë këngë”?

“Kjo këngë është e magjishme. Është këngë për vendin e parë në top listë. E unë kurrë s’kam dëgjuar këngë më të mirë”. Vaji i fëmijës menjëherë kthehej në gaz. Fundja, a kishte ndonjë arsye fëmija të qante para se t’i vdiste i ati në luftë?

9. ZORAN ANÇEVSKI (MAQEDONIA E VERIUT)

NATYRA DHE SHOQËRIA

1.

Shpërtheu liqeni, dhe pas tij
vëllezërit e tij më të vegjël – pusët.
Peshqit pjellin në të thatë
dhe janë pre e lehtë për zogjtë dhe njerëzit.

Bretkosat pushuan së kuakuri -
tash është radha jonë të këndojmë dhimbshëm
për atë që ia mohuam vetes.
Një vrushkull rrezesh çanë qiellin vjeshtak

dhe kërkuan sipërfaqen e liqenit
për t'i gjetur peshqit e arratisur
nga rrjetat e ngatërruara të hajdutëve
dhe për tu rrënjësuar besim të ri në jetë.

2.

Sërish është errët në vendin tim liqenor -
bukuria është varur në aletë e thara
që janë hije murgjish në një litani të ngadaltë.

Syve i rrjedhin mërgimet e rënda:
as strumbullari nuk mund t'i mbajë më
shpirtrat me ngjyrë bore që largohen.

Nuk ka as vallen teshkoto ta luaje këtu,
edhe zurlat ia mbathën përtej kujtesës
në majat e larta që nuk i meritojmë.

Edhe të sëmurin për ilaç nuk ka kush ta marrë
përgjatë livadheve të mbuluara me copa kashte,
myku e kap drithin e pa lidhur në dujë.

Shoh, mola me myshk tek vijnë dendur në tufa,
prej tyre edhe lypësit ngrinë nga frika -
nuk ka pasur kurrë heshtje dhe tmerre të tilla:

gjethi i thatë i duhanit kallëpet trashë në deng
dhe paralajmëron dimër me një qiell të rënduar e të përmbysur.

10. LOR KAMBO (FRANCA)

PËR PAK TË DASHUROHEM ME NJË STOL

por ti u ule mbi të
nën orën e murit prej kockës kofshës
dhe mendove se sytë e mi janë porta

shpirtrat brenda meje u shkrin me shiun
mbetën vetëm ca guralecë të ngadaltë
që kërcenin dhe rrotulloheshin
ti nuk e mbaje përjetësinë në çdo kat

për pak të dashurohem me një stol
por ti u ule mbi të
nën orën e murit prej kockës kofshës
i hollova pikat e shiut sipas ngjyrës
sipas moshës dhe temperaturës

i lashë sytë e tu dhe çdo shpresë me valixhet
pranë banakut me njerëz
dhe u ktheva në mitrën e dreqit
duke ndjekur hënën e gjelbër për gjëra të mëdha
më pyeti për drejtimin e rrugës pa ngjyrë
rrugën drejt infektimit

atëherë përmes vrimës së çelësit të bravës së lashtë
të tregova se ç'është jeta e vërtetë
në anën tjetër të rrënojave dhe pjesët e shembura të lumit
ngarkuar me shpirtra dhe lëngje engjëjsh nga të gjitha trojet
të ngjeshur për të mposhtur fjalët dhe mendjet që luajnë bixhoz

për pak të dashurohem me një stol
por ti u ule mbi të

11. LULZIM HAZIRI (MAQEDONIA E VERIUT)

ËSHTË VJESHTË...

(Lindita Ahmetit, poete)

Pikojnë gjethet e manjolës në këtë vjeshtë
Siç bien engjëjt e plakur me fjet
Prajshëm palosen mbi barin jeshil
Mbulojnë njëra tjetrën shpina mos u mërdhij
Pastaj fryn një erë nga gjumi i zgjon
Se vijnë engjëj tjerë të zverdhur verem
Si t'pikur nga qielli luhaten me nge
Shtrihen përmbi tokë, dergjës i bëjnë vend
Është vjeshtë ...

12. TOM PECINIS (AUSTRALIA)

MJESHTRI I VJETËR

(Mikis Theodorakis, Teatri Palais, Melburn)

Hapa, dystaban, te banaku i pritjes,
kokën shtrënguar ëndrrash shtatëdekadëshe,
kompozimesh që sfiduan pentagramin
Eh nga ajo që u kthye në këngë për Zorbën.

Me flokët gri si një profet i lashtë,
shumë të fryra për krehër nga persekutimi i gjatë,
nxit një zhurmë të paparashikuar në partiturë
dhe përgatit orkestrën me një pohim koke.

Alegro: pëllëmbët e përdredhura si bretkosa laramane
shndërrohen në dallëndyshe që thurrin
re dimri mbi qendrën e fshatit, thurin fole
nga copat e shpresës, errësirës dhe dëshpërimit;

ju jeni si duart e një poçari, që janë shkrirë
shtyp, përdredh, formësoj kohën e heshtur,
jepni një kthesë për një temë prekëse -
një amforë me të rinj në një valle precize;

pastaj, thuajse duar plake, pa frikë,
futen në mitrën e violonçelit,
duke bërë një tingull foshnjeje, i zgjatur
ulërimë, e ngritur lart, gëzim për çdo sy.

Pianissimo: lëvizjet e tij janë përkëdhelëse,
ngushëlluese, për një vajzë të përzënë nga Selaniku,
e cila, duke qarë yjet e ngjeshur,
dredh kaçurrelat gjembore në tepen e saj;

përqafon varreza të lëruar nga tankset,
tash të mbuluar me dritë hëne dhe gëlqere,
ku shpirtrat mbledhin kockat e tyre të shpërndara
për tu kapur nesër në vallen e nuses .

Kreshendo: sytë mbyllur, zëri forcohet,
hedh në të një rrjetë lëkure të rrudhur
që lufton kundër gravitetit dhe hapësirës
dhe me goditje rivendos heshtjen midis notave -

shpatullat e tij të pjerrëta, të fryra
dhe të lëvizëshme nën këmishën e zezë të gjërë,
thua ti se janë krahë kryeengjëlli hovi i të cilëve
do t'i çojë në parajsë ata që mbetën pa frymë.

Pa u vënë re nga askush, i ngrihet thembra e majtë,
ndalon, si një sprinter gati për finishin,
por vetëm pas një rrahje zemre, nëse jo gjysmë,
zbret sërish, së bashku me të dyja duart.

I hutuar për një moment nga fundi,
publiku i ulur ngrihet befas me duartrokitje,
ngritet në gishtat e këmbëve duke bërtitur: biiiis, biiiis,
maestro, magjistar, mrekuilibërës.

I lodhur nga emocioni që solli në një mijë zemra,
përkulet dhe shkon andej nga erdhi:
Sërish i shndërruar në trup me pëllëmbë të mëdha anash,
pesha e lodhur që e tërheq poshtë kah hija.

13. FILIPA SARA POPOVA (MAQEDONIA E VERIUT)

EKO LËKURË

Trupi im është baltë e kuqe e thatë,
dhe shpirti korrespondoncë midis perëndive të vdekura. Vetëm,
si një peshk i fjetur notoj në shpinë
në lumin e tharë. Kërkoj
stërkalla në detë, e veshi
shndërrohet në guaskë të thyer,
gjithë etja në plehra
dhe çdo gjëmim në asfalt.

Trupi im është baltë e kuqe e thatë
që dikur ruante ujë të furishëm. Tani
kujdesem për veten time të vdekur
i mërmëroj gjithë magjitë, i ndjek të gjitha ritet
fërkohem deri në zbehje
fshihem në vetvete deri në zhdukje.
Sërish e zhvesha lëkurën,
a do të ketë një të re këtë herë?

14. OLIMBI VELAJ (SHQIPËRIA)

KOHA E KAMBANAVE

Shpresojmë, por
vjen koha e kambanave
me të vdekurit që psherëtijnë
nën kostmet e zeza
dhe lulet e thata
Ajri tendoset nën peshën e heshtur
të ankthit, në oborrin e kishës
qarkuar me aromë parafine
Engjëj baresin nëpër mure
sipas besimit dhe dëshirës
tjetër trajtë ka koha
nën fytyra të lodhura shenjtorësh
dhe psalmesh buçitës
Do të doja të vdisja
në ndonjërin nga këto ditë
pa ateizmin tim
dhe erotikën e largët
që mbërrin qiellin
përpara lutjeve dhe qirinjve

15. IVICA ÇELIKOVIQ (MAQEDONIA E VERIUT)

KËNGË E DYSHIMTË

Detarët në portet e deteve të veri`ut
flasin në gjuhë të pakuptueshme
dhe me forma të paqarta trupore
i lënë fytyrat e tyre në karriget e forta të kafeneve

dikush shkroi disa rreshta
duke mbajtur kryqin në gjoks
në hijen e kopertinave të zbehura të biblës
e plotësuar me kapituj të rinj

vështirë njihen shkronjat
të cilat mes tyre bëjnë një luftë të tmerrshme
që nuk di si të zgjerohet
në kontinent

askush nuk e di
të gjithë dyshojnë
ulin velat
dhe kthehen kah gjërësia e detit
të lënë me njëri tjetrin
duke mermëruar se kthimi që iu mor
thjesht nuk ekziston

16. SHĪ ÇUĀN (KINA)

E FSHEH BISHTIN

Fsheh bishtin tim, u përziva me njerëzit që fshihnin bishtin.

Përkulem me qëllim që t'i afrohem hijes, por edhe hija është mbledhur sikur do t'ia mbajë.

Kur do të pija deri sa ngihem ujë të ftohtë, do të mundja të mbytja mendimet e brendshme.

Duke ecur, shtrij krahët, por pa lypur asgjë nga bota. Megjithatë, a mund të ndodhë diçka vetvetiu që t'më bjer në duar?

Xhami i thyer më preu gishtat, por mushkonja fluturoi pa u vërejt nga askush.

I ushtroj sytë, t'më bëhen të mprehtë si sytë e shqiponjës. Kështu, duke u munduar të shoh qartë, ngërçi i zemrës nuk do të ketë më ku të t'më ik.

Në rast se më afroresh sërish, s'do të mundem me t'pa përmes teleskopit. E kam vendosur teleskopin vetëm me t'pa ty, ndaj rri sa më larg meje.

Petalet në rrugë, mos janë thonjtë e thyer të 'Shī Shi'-së?

Kur të tjerët përsërisin budallallëqet që kam bërë unë, nuk kam si i ndaloj. Por kur i përsëris unë në këtë mënyrë tregoj se sa dinak jam.

Unë nuk mund të qëndroj pranë të çmendurve duarlidhur nga e liga e zakonshme, as nuk mund të qëndroj pranë të zakonshmes duarlidhur nga e liga e të çmendurve.

Njerëzit e zgjuar shehin se si ta shpenzojë arsyen e tyre para se të errët.

Duke shikuar nga hëna, mbështetur në zilen e biçikletës, ndërsa s'e mbaj dot veten të hingëllij si kali në hënë. Dhe në hënë - gjithçka është e qetë.

E martë, një tis i hollë tymi mbi qiriun e fikur.

Të mërkurën, mizat e jugut mundën mizat veriore.

Me një të shkelur të gazit të makinës I thërras minjtë në kuvend. Ata janë të kënaqur dhe unanim: Vërtet bota duhet të shkojë në ferr, por ata nuk e meritojnë ferrin.

Mos i trembni njerëzit, trembni njerëzit që nuk janë njerëz, ata duhet të frikësohen aq sa duhet tu bëhet lajka.

Me monedha stampoj harta në lëkurën tënde.

Ju peshoni peshën e qiellit. Vetëm argëtohu, në rregull. Nëse je serioz, do të më duhet të të mbys për vdekje.

Endacakë të natës, ne i shmangemi njohjes.

17. SANDE STOJÇEVSKI (MAQEDONIA E VERIUT)

TEPOSHT

Engjëjt bien nga simbolet
e larta, të shëmtuar sillen
kah komoditeti në vargjet
e moçme, përtej syve i rreh

acari i ashpër nga lart,
nga hinka hapsinore
e hapur, lot nga i pamëshirshmi
sy, duke parë botërat
që presin të shkelin
pragun e simboleve të reja
apo të vjetra, të valvitura në të ftohtë.

Sikur të shfaqej së paku një pemë
në kodër, kërcitja e një dege të thatë,
si në ato elegjitë e famshme.

18. KLAUDIO POZZANI (ITALIA)

MARSHIMI I HIJES

Litarët bien nga qielli
rreth teje vallëzojnë zinxhirë të ftohtë
Bota është bërë nga nyjet
që në errësirë duhet të zgjidhen
mes dy
vetëtimave fosforeshente dhe kërcitëse
Ngatërrim litarësh
gërshërësh që largohen
Krehër që ngatërrohet
në flokët e ashpër

Hije është ... hije
sërish pulitje qepallash

Rreth meje shoh mure
dhe pasqyra ime është bërë mur
të ka mbi lekurë muri ne gjoks
shqisat e mia u rimëshiruan me murin
Dhe ende reshin lutje dhe mallkime
që avullojnë në kontakt me rërën
dhe në heshtjen helmuese ende zvarriten
ndajfoljet, mbiemrat, fjalët pa zë

Dhe hije... hije ...

dhe sërish pulitje qepallash

Shkëlqimin e diellit

vetëm në vorbullat e ylberta të shiut e shoh

praninë e hënës e ndjej në errësirë

përmes lehjes së largët të qenve të lidhur

Paqja ime nuk është mungesë lufte

Paqja ime është mungesa e nocionit luftë

Jo hije...hije...

sall edhe një pulitje e qepallave.

19. GLIGOR STOJKOVSKI (MAQEDONIA E VERIUT)

VJEN

Po-vjen

nga gropat ngjitëse
fryma e shkëlqimit të zi
me turr të gjerë
me gishta të shtangur
gërvisht në muret e lashta
për të çliruar nxehtësinë
zhbirohet korridoreve metalike
i zgjeron
i shkrin
u hap rrugë të ngecurve
të fortëve
u rritet në pëllëmbë
vjen
me shenjë të zbehtë në ballë
shqipton fjalë të rëndësishme
në gropa
në humnera të harruara
i krijon sërish
për tu ripërtëri
purgatori i madh
në fushën e gjallë të hirit

20. KALINA IZABELLA ZIOLA (POLONIA)

DY PLANETE

flasim gjuhë të ndryshme
jo se jetojmë në vende të ndryshme
por sepse vijmë nga planetë të ndryshëm
ti je nga Marsi dhe unë nga Venera
Ti je luftëtar pushtues
dhe unë jam një yll romantik ëndërrimtare endacake
ti Tarzan, unë Xhejn
ndonjëherë takohemi në gjysmë të rrugës
kërkojmë shteg të ngushtë buzë detit
për të kapur erën në duar ose për të numëruar yjet në qiellin tonë të
përbashkët
pastaj largohemi përsëri
mbyllemi në botët tona të veçanta
ku jo do të thotë po dhe po do të thotë jo
Nuk të dëgjoj dot, nuk më kupton dot
Ti je Tarzani dhe unë Xhejn

21. SUZANNA V. SPASOVSKA (MAQEDONIA E VERIUT)

PEMË E SHENJTË

Është gjithmonë në qendër të kopshtit

Pavarësisht nga cili kopsht

Çdo kopsht

ka pemën e vet të shenjtë

dhe njerëzit e tij që e ruan

Shumë popuj

e kanë pemën e tyre të shenjtë

që e mbrojnë me jetët e tyre

Vetëm nën tokë

të gjitha pemët e shenjta

ushqehen nga një rrënjë e përbashkët

– pema e jetës

22. DAVOR SHALLAT (KROACIA)

ËSHTË MË MIRE TË FLASËSH ME PAGJUMËSINË

Pluhuri i fajit është shtri mbi ty,
zjarri pa nda flakëron në kofshët dhe sytë e tu.

Fjala është top
që ti, sa më shumë e shtyp
aq më lehtë bie nga duart.

Është mirë të flasësh me pagjumësinë,
me atë teatër të vogël rëniesh
në të cilën aktorët të japin katarsis,
Thua se është një bimë shëruese.

Mëngjesi është trillim për naivët,
drita e jashtme e cila
nuk mbërrin deri në fund.

Faji yt të shpëton
nga fitorja e kurdisur,
të sjell një pasqyrë të mëshirshme
që të pyet dhe të ngushëllon.

Si një nënë e zhveshur nga gjithçka
që nuk është mëmësi.

23. JOVICA IVANOVSKI (MAQEDONIA E VERIUT)

SHEGË NË PËLLËMBË

Agimi i lidhi plagët e natës.

Mëngjesi ra nga pishat, jo si

boçë por si rrëshirë mbi makinë.

Roletat ngrihen me dy duar.

Gjiri e zbut detin si

vece-guaska diarrenë.

Kafshoj kashtën ndërsa bari

rritet 3 deri në 4 milimetra në ditë.

Kanoe pa lopatë është si një lopatë pa kanoe.

Shegët të çelme për pëllëmbët e mia.

Brekët e plazhit thahen pa tel.

Mbrëmje e re, jam më i vjetër se shumica.

Xixëllonjat janë yje të rënë që

kërkojnë rrugën drejt ballit tonë.

Jeta e verës Beaujolais është e shkurtër, është e shkurtër

mosha e gjithçkaje që ka lindur dhe mbirë në

këtë planet të përkryer.

Unë jam i spërkatur me gjakun e

shegës që pak më parë, si një partizane

e plagosur, më vdiq në duar

24. FARID HUSEIN (AZERBAJXHANI)

SI ËNDËRR

Na kanë mbetur shumë
ditë të mrekullueshme.
Shkaku i këtyre çasteve, kemi
të drejtë për të folur gjithmonë për të kaluarën.
Emrat na janë gdhendur
në pemën që bën hije
mes një fatkeqësie të madhe.
Nuk kemi inat për ditën e djeshme.
Qëllimi i historisë sonë është i mirë,
nëse flasim vetëm për tema të njëjta,
kjo s' do të thotë se jemi pleq.
Mëkatet na verbuan sytë,
kah dielli nuk mund ta shikojmë.
Ndarja nuk do të jetë e dhimbshme
nuk do të plagosë gëzimin e gjallë.
Bota kish bë një dritare -
shikova përtej saj dhe të pashë
dhe kudo që shkoja
e mbaja me vete dritaren
që shikon kah ti.